



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:148418  
Datë: 30.09.2024  
Numri i dokumentit: 06232413

**C.nr.2494/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me praktikanten A.Ç. në çështjen kontestimore të paditëses F.Ş. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku & ..... nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 798.61 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 30.09.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.Ş. nga Prizreni.

**DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.07.2019- 31.12.2019, në shumën prej 63.66 euro
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 01.01.2020, në shumën prej 9.43euro
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 160.32 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 21.11.2022, në shumën prej 487.71 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 721.14 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. REFUZOHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses F.Ş. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 798.61 euro, përkatësisht shuma prej 77.47 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja F.Ş. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. S.K. nga Prishtina, ka ushtruar padi më datë 21.07.2022 kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në shkollën “Abdyl Frashëri” në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, është në lartësi prej 798.61 euro. Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Përmes parashtresës së dt.08.07.2024, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka kërkuar kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore 06.07.2019 deri 21.11.2022, është në lartësi prej 798.61 euro, llogaritur në pagën bazë që e njëjta e realizon në shumë prej 421 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 20.10.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësve nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu, ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës Nr.prot.346 e datës 11.12.2020 për paditësen e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, si dhe nga

vërtetimi nr.191 më datë 16.06.2021 vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën “Abdyl Frashëri”, si edukatore dhe ka përvojë pune 10 vite ndërsa nga lista e pagave nr.EM00088497 konstatohet paga bazë prej 393 euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 63.66 euro ( $393 * 2.7\% = 10.61 * 6 \text{ muaj} = 63.66 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 9.43 euro ( $393 * 0.2\% = 0.78 * 12 \text{ muaj} = 9.43 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.32 euro ( $393 * 3.4\% = 13.36 * 12 \text{ muaj} = 160.32 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 393.00 euro i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 487.71 euro ( $393 * 11.6\% = 45.58 * 10 \text{ muaj} = 455.80 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është euro sipas llogaritjes ( $45.80 / 30 = 1.53 * 21 \text{ ditë} = 31,91 \text{ euro}$ )= $455.80 + 31.91 = 487.71 \text{ euro}$ ).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata ka trajtuar kërkesën e paditëses nga data 01.07.2022 dhe jo siç është specifikuar nga data

06.07.2022 pasi që llogaritja e kërkesës nga paditësja është në tërësi për muajin Korrik 2022 dhe mbi këtë bazë gjykata e ka trajtuar si gabim teknik datën 06.07.2022

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 21.07.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2019 e deri më 21.11.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 21.07.2022. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Korrik 2019 respektivisht nga data (01.07.2019) pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin Korrik 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e muajit Korrik 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit Korrik 2019 rrjedhimisht i njëjti atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Korrik 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht 01 Gusht 2019, i njëjti ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditësit për periudhën 01.07.2019 e deri më 21.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, gjykata ka refuzuar kërkesën padinë e paditëses në lartësi prej 77.47 euro pasi që paga bazë e paditëses është 393 euro dhe jo siç ka pretenduar paditësja në lartësi prej 421 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (21.07.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e

Numri i lëndës: 2022:148418

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06232413

shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2494/2022, datë 30.09.2024**

**G j y q t a r i**

Taulant Rexhëbeqaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.